

## **Shqipëria: Eksperti i Kombeve të Bashkuara mirëpret përfshirjen e grave në qeverisje, bën thirrje për veprim lidhur me personat me aftësi të kufizuara**

TIRANË/GJENEVË (24 Nëntor 2022) – Përpjekjet e Shqipërisë për përfshirjen e grave në qeverisje meritojnë të njihen, por vendi mund të bëjë më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara dhe të komuniteteve rurale në zhvillimin politik, ekonomik dhe shoqëror, tha sot eksperti i Kombeve të Bashkuara.

Në fund të vizitës 10-ditore në vend, Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Zhvillimit Saad Alfarargi, lavdëroi përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të siguruar pjesëmarrjen e grave në qeverisje dhe në organet vendimmarrëse, përfshirë qeverisjen qendrore dhe shërbimin civil

[\[https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/issues/development/sr/2022-11-23/20221124-eom-albania-sr-rtd-albanian.pdf\]](https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/issues/development/sr/2022-11-23/20221124-eom-albania-sr-rtd-albanian.pdf) .

“Shqipëria ka bërë një përparim mbresëlënës në rritjen e rolit të grave në organet vendimmarrëse”, tha Alfarargi. “Vendi gjithashtu po punon për të arritur një shkallë të lartë përfaqësimi të grave në nivelet drejtuese në sektorin e biznesit,” shtoi ai.

Raportuesi i Posaçëm tha se u kënaq kur mësoi nga organizatat e shoqërisë civile se ishin përfshirë në diskutime që kontribuojnë në hartimin e politikave dhe ligjeve për zhvillimin e vendit.

“U kënaqa akoma më shumë kur mësova se pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e konsultimit të lidhura me përpunimin e strategjive kombëtare dhe lokale dhe planet e veprimit, si edhe me buxhetimin, është detyrim i parashikuar në shumë ligje,” tha eksperti.

Alfarargi vuri theksin tek sfidat e mbetura lidhur me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, përfshirë në përgjithësi mungesën e mundësive për qasje në shërbime publike dhe përfaqësimin e pakët në qeverisje.

“Jam i shqetësuar gjithashtu se, pavarësisht nga përpjekjet e Qeverisë, zhvillimi i komuniteteve rurale ka mbetur prapa, duke çuar në përhapjen e varfërisë, papunësi dhe lënien pas dorë të njerëzve që jetojnë në zonat e thella dhe zonat rurale,” tha eksperti i Kombeve të Bashkuara.

Raporti i hollësishëm i Raportuesit të Posaçëm për vizitën dhe rekomandimet e tij do të paraqiten përpara Këshillit për të Drejtat e Njeriut në shtator 2023.

## Fund

Z. Saad Alfarargi (Egjipt) është emëruar i pari [Raportues i Posaçëm për të Drejtën për Zhvillim](#) nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut në vitin 2017. Z. Alfarargi ka shërbyer si Ambasador në Ligën e Shteteve Arabe në Kombet e Bashkuara dhe në Organizatat Ndërkombëtare në Gjenevë (1998-2012); Drejtor Rajonal për Shtetet Arabe, Asistent Administrator, UNDP, Nju Jork (1995-1997); Ndihmës i Ministrit të Punëve të Jashtme të Egjiptit; Shef i Zyrës së Presidentit për Çështjet Ekonomike, Kajro (1992-1995); dhe Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm i Egjiptit në Kombet e Bashkuara dhe në Organizatat Ndërkombëtare në Gjenevë. Ai është diplomuar dhe ka bërë një Master Shkencor në Universitetin e Kajros, si dhe ka marrë një diplomë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga London School of Economics.

Raportuesit e Posaçëm janë pjesë e të ashtuquajturave [Procedura të Posaçme](#) të Këshillit të të Drejtave të Njeriut. Procedurat e Posaçme, organi më i madh i ekspertëve të pavarur në sistemin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së, është emri i përgjithshëm për mekanizmat monitoruese dhe faktmbledhëse që adresojnë situatat specifike në vende të ndryshme në të gjitha pjesët e botës. Ekspertët e Procedurave të Posaçme punojnë në mënyrë vullnetare; ata nuk janë staf i OKB-së dhe nuk marrin pagesë për punën që bëjnë. Ata janë të pavarur nga çdo qeveri apo organizatë dhe shërbejnë në cilësinë e tyre individuale.

Të Drejtat e Njeriut të OKB-së, Faqja zyrtare — [Shqipëri](#)

Për më shumë informacione apo pyetje, ju lutemi kontaktoni: në Shqipëri, znj. Nora Kushti +355 692090253/nora.kushti@undp.org); në Gjenevë: znj. Antoanela Pavlova (antoanela.pavlova@un.org) ose shkruani në [hrc-sr-development@un.org](#).

Për pyetje nga media në lidhje me ekspertë të tjerë të pavarur të OKB-së, ju lutemi kontaktoni Renato de Souza ([renato.rosariodesouza@un.org](#)), ose Dharisha Indraguptha ([dharisha.indraguptha@un.org](#))

Ndiqui lajmet në lidhje me ekspertët e pavarur të të drejtave të njeriut të OKB-së në Twitter: [@UN\\_SPExperts](#).

Të shqetësuar për botën ku po jetojmë?  
**Atëherë, NGRIHUNI për të drejtat e dikujt sot.**  
#Standup4humanrights  
dhe vizitoni faqen zyrtare në <http://www.standup4humanrights.org>